



# NDËRMARRJA PUBLIKE BANESORE PUBLIC HOUSING ENTERPRISE

Adr: Rr. "Xhevdet Doda" nr. 32 - Prishtinë-Kosovë  
Tel: +381(0)38 553 311/523 001; Fax: +381 (0)38 522 446  
e-mail: npb@npbanesore.com web: www.npbanesore.com

Në bazë të dispozitave të Nenit 8 të Ligjit të Punës, Ndërmarrja Publike Banesore Sh.A Prishtinë, shpall:

## KONKURS

**Për zgjedhjen e dy (2) pozitave Pastrues/e në Departamentin e Mirëmbajtjes , në Ndërmarrjen Publike Banesore – SH.A me seli në Prishtinë.**

### Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Bën pastrimin e objekteve banesore të kontraktuara për mirëmbajtje;
- Pastron dhe mban higjienën e shkallëve të hyrjeve banesore;
- Mirëmban mjetet e punës që i përdorë;
- Kujdeset për higjienën e liftit;
- Pastron dritaret dhe gjërat e tjera në hapësirën e përbashkët të hyrjeve;
- Për punën e vet i përgjigjet Mbikëqyrësit të Pastrimit;
- Kryen edhe punë të tjera me kërkesë të mbikëqyrësit të tij/saj.

### Kualifikimi dhe kushtet tjera të veçanta:

- Të ketë të kryer shkollën fillore;
- Preferohet së paku një (1) vit përvojë punë relevante;

### Procedura e Konkurrimit

Kandidati-ja për pozitën **Pastrues/e në Departamentin e Mirëmbajtjes** duhet t'i dorëzoi këto dëshmi:

- CV-në;
- Dëshminë e Shkollimit;
- Dëshminë për Përvojën e Punës;
- Kopjen e Lejës së Njoftimit; dhe
- Referenca të tjera që janë të rëndësishme për këtë vend pune.

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen në këtë adresë: **Ndërmarrja Publike Banesore - SHA në Prishtinë, rruga "Xhevdet Doda",nr.32, Prishtinë** ose përmes e-mailit zyrtar: [burimet.njerezore@npbanesore.com](mailto:burimet.njerezore@npbanesore.com).

Kandidatët të cilët konkurrojnë duhet ta shënojnë saktë adresën dhe numrin e telefonit kontaktues, si dhe e-mail adresën. Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për intervistë. Dokumentet e pa kompletuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen. **Konkursi është i hapur nga data 16 Janar 2019 – 31 Janar 2019 ora 16:00.**